

BREAKING NEWS

KUSH E KËRCËNOI DHE KANOSI SPAK-UN? VJEN PARALAJMËRIMI I FORTË I SHBA-SË, JA ÇFARË



AKTUALITET

Shitje droge, armëmbajtje pa leje dhe vjedhje automjesh, policia vë në pranga 5 të rinj, mes tyre edhe një femër

SHKRUAR NGA ALBIONA LIPO
6 GUSHT 2020




Mbrëmja e së hënës ka qenë terrorizuese për banorët e zonës në afërsi të fshatit Panarit në Skrapar, pasi pesë të rinj kanë qëlluar në ajër, me armë zjarri kallashnikov, duke përhapur panik. Burime nga policia bëjnë me dije se pas kryerjes së aktit, personat në fjalë janë arrestuar menjëherë nga autoritetet policore, ndërmjet tyre dhe një femër që kishte thyer masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”. Mësohet se autorët e ngjarjes pasi kanë parë shërbimet e Policisë, fillimisht kanë tentuar të largohen me vrap duke hedhur armët e zjarrit në një zonë të pyllëzuar, por më pas janë kapur gjatë ndjekjes nga policia. Gjithashtu mësohet se policia ka sekuestruar në cilësinë e provës 1.636 fara kanabisi, tri armë zjarri kallashnikov, lëndë narkotike, një motomjet të vjedhur, municion luftarak dhe një automjet fuoristradë me të cilin qarkullonin personat e arrestuar.


Detaje nga ngjarja, njoftimi i policisë

Lidhur me ngjarjen ka reaguar edhe policia, përmes një deklarate për shtyp të shpërndarë për median, me zbardhjen e plotë të ngjarjes. Sipas saj, falë bashkëpunimit nga ana e DVP Berat me Komisariatin e Policisë Skrapar është bërë i mundur arrestimi i 5 personave pasi qëlluan me armë zjarri në fshatin Panarit, Skrapar. “Operacioni nga DVP Berat, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Skrapar. Qëllonin me armë zjarri duke krijuar panik tek banorët, vihen në pranga 5 persona, ndërmjet tyre dhe një shtetase që kishte thyer masën e sigurisë "Arrest në shtëpi" të dhënë nga Gjykata, për veprën penale “Prodhimi dhe shitje e lëndëve narkotike” kryer në bashkëpunim”, deklarën policia. Gjithashtu mësohet se janë sekuestruar tri armë zjarri kallashnikov, lëndë narkotike, fara cannabisi, një motomjet i vjedhur, municion luftarak dhe një automjet fuoristradë me të cilin qarkullonin personat e arrestuar. Menjëherë pas ngjarjes, banorët e zonës kanë njoftuar autoritetet policore, të cilat më pas kanë rrethuar zonën. “Specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe Narkotikëve në Drejtorinë Vendore Berat, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Skrapar, pas njoftimit të marrë nga banorët e zonës se në afërsi të fshatit Panarit, Skrapar, po qëllonin me armë zjarri në orët e vona të mbrëmjes, menjëherë organizuan punën, duke zhvilluar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Panariti". Për shkak të errësirës dhe sigurisë së jetës të punonjësve të Policisë, gjatë natës është rrethuar zona dhe janë mbajtur në vëzhgim me dylbi nate, 5 personat që herë pas here qëllonin me armë zjarri në ajër. Me rënien e ndriçimit, shërbimet e Policisë janë afruar dhe u kanë bërë thirrje të mos bënin asnjë veprim, por t'i bindeshin urdhrat të Policisë”, deklarën policia. Autorët e krimit mes tyre dhe një femër janë arrestuar për veprat penale për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikim i mjeteve motorike”, “Armëmbajtja pa leje”, “Prishja e qetësisë publike”, “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” dhe “Moskallëzimi i krimit”. Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë, i shtetasve: R. D., 25 vjeç, banuese në Berat, e cila ka qenë me masë sigurie “Arrest në shtëpi”, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” kryer në bashkëpunim; D. (E.) D., 42 vjeç, i dënuar më parë për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotikëve”, M. Sh. alias A. D. alias S. D., 35 vjeç, A. S., 43 vjeç dhe F. (A.) M. (Xh.), 33 vjeç, banues në Berat”, deklarën policia. Ndërkohë materialet proceduriale do t'i kalojnë për ndjekje të mëtejshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.


Më të lexuarat




Zëri i Amerikës tregon biznesin që po has vështirësi në Tiranë: E nënvlerësuan gjatë pandemisë




“Thuaj që koronavirusi i mori jetën”, gazetari i lexon mesazhin e papritur ‘live’ Pëllumb Piperos, ja si reagoi mjeku




“Ka zëra se pacientëve me Covid-19 u merret celulari”, Pëllumb Piperos tregon si qëndron e vërteta




"Rama pjesë e këtyre qarqeve", Gazmend Koduzi nxjerr prapaskenat e rënda, tregon se çfarë fshihet pas koronavirusit




Përplasen dy motorë, humb jetën një person, një tjetër plagoset rëndë




Lufta me COVID-19 në Shqipëri/ Ministria e Shëndetësisë zbulon gjendjen e pacientëve: Po trajtohen 122 persona




Humb jetën nga koronavirusi një 58-vjeçar nga Tirana, shërohen 72 persona




Regjistrohën 135 raste të reja me koronavirus në 24 orët e fundit në Shqipëri




Ulet ndjeshëm numri i vdekjeve nga koronavirusi në Kosovë



VIDEO/ Policia rrugore me dorë të fortë, fluturonte me 239 km/h, drejtuesi i superbenzit e pëson keq në autostradë, merren masa të forta



“Shqipëria nuk ka blerë kurrë kite”, Gazmend Koduzi del me deklaratën e fortë dhe shpjegon pse tamponët nuk nxjerrin rezultat in e saktë: E kanë fallco pozitivitetit



Fundjavë e trazuar/ E shtuna me shi e shtrëngata, por ja si do jetë e diela, njihuni me kapriçot e motit

Mesazhe Promocionale

Gossip




■ ■ ■ ■ ■

Bes Kallaku jep lajmin e trishtë, humb njeriun e dashur: Të pabesueshme janë ndarjet


Aktori Bes Kallaku ka ndarë me ndjekësit e tij në rrjetet socia...

Opinione




PANDELI BARDHI

“Delet” në Parlament dhe “çakalli” president!...




PIRRO PRIFTI

Zgjedhjet në Bjellorusi frika për një Maydan të...



SKËNDER KAPITI

Cili është parimi i politikanëve shqiptarë?



RAMAZAN SHERJA

Të mbash fjalën e dhënë është dinjitet

LEXO OPINIONE TE TJERA